



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 54, Datë 03.03.2025

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “GREEN ENERGY TRADING ALBANIA” SH.P.K.  
PËR HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, germa “dh”, 7, paragrafi 2 dhe 9, gërma “d”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 5.1, gërma “dh”, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të Energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.03.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 260/4 prot., datë 28.02.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., e licencuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 59, datë 23.04.2015 të bordit të ERE-s, dhe me licencë të rinovuar për një afat 5-vjeçar me vendimin nr. 72, datë 22.04.2020 (deri më 24.04.2025), ka njoftuar ERE-n se nuk do të kërkojë rinovimin e licencës. Shoqëria ka vendosur të nisë procedurat e likuidimit dhe, për këtë arsye, ka kërkuar udhëzimet përkatëse.
- Pas shkëmbimit të korrespondencës me shoqërinë lidhur me detyrimet e saj dhe duke qenë se ajo është në fazën përfundimtare të likuidimit, si dhe bazuar në rakordimin e kryer, rezulton se aktualisht nuk ka detyrime ndaj ERE-s për pagesat e mëparshme të rregullimit. Në kushtet kur pagesat e rregullimit për vitin 2025 ende nuk janë përcaktuar, vlerësohet e arsyeshme miratimi i kërkesës së saj për heqjen e licencës.
- Në nenin 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenin 5, gërma “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë

18.04.2017; si dhe në pikën 5.1, gërma “dh” të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të Energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, përcaktohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.*

- Në nenin 7, paragrafi 2 i Rregullores së sipërcituar përcaktohet se: *Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, gërma “d” të kësaj rregulloreje parashikohet se ...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe / ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.*
- Duke qenë se ndodhemi në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të procedohet menjëherë me miratimin e kësaj kërkesë dhe heqjen e licencës.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k. e humbet fuqinë juridike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., për heqjen e licencës Nr. 286, seria T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 59, datë 23.04.2015 dhe rinovuar me vendimin nr. 72, datë 22.04.2020.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**